

## KËRKIME GJUHËSORE

---

Shpresa ISMAJLI

### TIPAT E MBIEMRAVE SIPAS FJALËFORMIMIT NË VEPRËN *MESHARI TË GJON BUZUKUT*

Vepra “Meshari” e Gjon Buzukut, na ka dhënë një pasqyrë të dokumentuar saktë të shqipes së kohës, prandaj, ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen e studiuesve. Prandaj, objekt studimi në kumtesën time kam pikërisht analizën e strukturës fjalëformuese të mbiemrave në këtë vepër. Ky punim është një përpjekje për të trajtuar mënyrën se si janë ndërtuar mbiemrat në tekstin më të vjetër të njohur të shqipes, për të dhënë në formë të përmbledhur një përshkrim për mënyrat dhe tipat fjalëformues të mbiemrave në shqipen e shek. XVI.

Siç e dimë, mbiemrat e shqipes, për nga prejardhja ndahen në mbiemra të parmë dhe të prejardhur.

*Mbiemrat e parmë:* Të parmë janë ata mbiemra, të cilët sot janë të paanalizueshëm në pjesët e tyre përbërëse, nuk mund t’u hetohet as tema fjalëformuese as ndonjë formant fjalëformues.<sup>1</sup>

Nyja të mbiemrat e nyjshëm, të cilëve u përgjigjet një ndajfolje me të njëjtën temë, nuk merret si formant fjalëformues, por si element thjesht gramatikor, kështu këta mbiemra nuk trajtohen si fjalë të formuara nga ndajfolja përkatëse, por si fjalë të parme.<sup>2</sup> Mbiemra të parmë në veprën e Buzukut na dalin një numër mjaft i madh: *i ambël, i afërë, i bukurë, i begatë, i bardhë, i butë, i dërejtë, i gjallë, i egërë, e fortë, i keq, i kërshenë, i kuq, e ligë, i mjerë, i mirë, i madh, i mbarë, i naltë, i ri, i shkretë, i vobeg, i vërtetë, i vorfën, i vogël, i shkretë, i urtë, i verdhë, të veja, të thella, e thatë*, etj.

*Mbiemrat e prejardhur:* Edhe të Buzuku, sikurse në shqipen e sotme, numri i mbiemrave të prejardhur është më i madh se i atyre të parmë. Këta mbiemra na dalin të formuar nga fjalët tjera, me anë formantesh të ndryshme fjalëformuese. Në veprën e Buzukut na dalin këta tipa mbiemrash të prejardhur:

- mbiemra me parashtesim,
- mbiemra me prapashtesim,
- mbiemra me paranyjëzim,
- mbiemra me paranyjëzim dhe prapashtesim njëkohësisht,
- mbiemra me kompozim

*Mbiemra të prejardhur me parashtesim:* Në librin e Buzukut, na dalin mbiemra të formuar me këto parashtesa:

- me parashtesën *dë-* : *i dëlirë*
- me parashtesën *m-*: *i mplakunë, i mbegatë*
- me parashtesën *n-* : *i ndhezunë, i nveshunë, i nvram, i nthellë, i nvaranëtë, e ngënjyeme, e ngënjyeshime*.

---

<sup>1</sup> Gramatika e gjuhës shqipe I, ASHSH- IGJL, Tiranë, 2002, f. 85.

<sup>2</sup> Po aty.

- me parashtesën *pa-*, nga tema mbiemërore: *i padrejtë, i padenjë, e pakeqe, i paditunë, i pakrështenë, e pamartuome, e papërmortshime, i panjohunë, i paçmuom, i pandigluom, të pabujtunë, të palana, të papërmortshime*

- me parashtesën *për-*, i përgjykuom, i përfaruam, e përdame, i përkatënuom, i përmishëriershim, të përhirshme, e përvutë,

- me parashtesën *shpër-*: i shpërblenë

- me parashtesën *x-*: i xveshunë

*Mbiemra të prejardhur me prapashtesim:* Mbiemra të formuar me prapashtesim në veprën në fjalë na dalin:

- me prapashtesën *-an*: *shtrigan*

- me prapashtesën *-ar*: *mortar, kurvare, letërar*

- me prapashtesën *-ës*: *(pleq) gjukatës*

- me prapashtesën *-tar*: *leshëtar*

- me prapashtesën *-tuor*: *fajëtuor,*

- me prapashtesën *-zë*: *të vogjëlizëtë*

- me prapashtesën *-shkë*: *e zeshkë*

*Mbiemra të prejardhur me paranyjëzim:* Me paranyjëzim në veprën Meshari të Gjon Buzukut, gjejmë një numër të madh mbiemrash, shumica **të prejardhur nga pjesorja e foljes**, dhe varësisht prej prapashtesës me të cilën pjesorja, këta mbiemra i kemi ndarë në:

- mbiemra të formuar me nyjëzim nga pjesore foljesh me prapashtesën **-unë**, që është shumë prodhimtare, dhe në veprën që kemi objekt studimi na dalin një numër i madh mbiemrash të tillë: *i mprehunë, i sosunë, i mujtunë, i reditunë, i ndhezunë, i dejunë (dejë), i djegunë, i qitunë, i vdekunë, i ditunë, i dukunë, i ecunë, i enbajtunë, i enbathunë, i enbytnë, i endenjunë, i enfshehunë, i engjeshunë, i enlidhunë, i enplakunë, i entherunë, i enveshunë, i enxitunë, i fëlliqunë, i grishunë, i gjegjunë, i ikunë, i shitunë, i thashunë, e trembunë, i zbardhunë, i zditunë, i pasunë, i puthunë, i qeshunë, i sosounë, i mytunë, i njehunë, i njohunë, i vobegunë, i vdekunë, i mitunë, i ruojtunë, i njëmendunë.*

Këta mbiemra në gjuhën e sotme letrare dalin më **-ur**.

- mbiemra të formuar me nyjëzim nga pjesore foljesh me prapashtesën **-m**, në veprën e Buzukut na dalin këta: *amëshuome, e bekuome, e dëshëruome, të dhunuome, i endërruom, i endigluom, i endijem, e faruome, e festuome, e glorifikuome, i gjykuom, i këmbiem, të kënduom, i lëvduam, i majm, i munduom, i mallëkuom, i nvarm, i ngënjem, e ngarkuome ( me kuptimin me barrë<sup>3</sup>), të ngushlluome, i përfaruom, i pëlqem, i publikuem, të penduome, e përdame, e përtërime, e pushuome, të qendruome, e rezuome, i shtuom, e shekruome, i vepëruom.*

Këta mbiemra në shqipen e sotme na dalin më **-uar** ose më **-r(ë)**.

- mbiemra të formuar me nyjëzim nga pjesore foljesh me prapashtesën **-në**, janë më të paktë: *i përzanë, i banë, i glanë, i shpërblenë, i panë, i pinë, i shkjepënë( mbiemër i emëruar), i shkurtënë, i shtrembënë, i shurdënë, i vofënë, i verbënë.*

<sup>3</sup> Çabej, E. *Studime gjuhësore*, VI, Prishtinë, 1988, f. 216.

TIPAT E MBIEMRAVE SIPAS FJALËFORMIMIT NË VEPRËN MESHARI TË  
GJON BUZUKUT

- mbiemra të formuar me nyjëzim nga pjesore foljesh me prapashtesën –të, janë këta: *e përvutë, e thatë, i nxitë, i fjitë, i nvratë, i shprazëtë, i errëtë*.

e) mbiemra me nyjëzim, të formuar nga pjesore foljesh me prapashtesën –ë, prej temash më –l, –ll, –r, –rr,<sup>4</sup> të Buzuku del *i dëlirë*.

Në shqipen e sotme me –ë dalin mbiemrat me temë më –r/rr, ndërsa ata me temë më –l, –dh dalin më –ur.

Mbiemra të prejardhur *me paranyjëzim, nga tema ndajfoljore: i afërë, i largë, i shumë*. Në shqipen e sotme, mbiemrat *i afërë, i largë, i shpeshë* na dalin të zgjeruar me prapashtesat –m dhe –të. Këto parashtesa kanë për qëllim që t'i diferencojnë akoma më shumë mbiemrat nga ndajfoljet përgjegjëse.<sup>5</sup>

Mbiemra të prejardhur nga *nyjëzimi i togut pa + emër*: Me këtë mënyrë formohen mbiemra nga nyjëzimi i togut *parafjalë + emër* dhe mohojnë zotërimin e një sendi nga sendi i karakterizuar pre tyre. Ky tip mbiemrash është paralel me formimet nga parashtesa *pa-* dhe mbiemrat më –shëm dhe po vjen duke u zëvendësuar prej tyre: *i pander – i pandershëm, i pafaj – i pafajshëm*, etj.<sup>6</sup>

- mbiemra të prejardhur nga togu *pa + emër* në veprën e Buzukut gjejmë: *i pagojë, i pajë, i paplang, i papushim, i pamasë, i pafrujt, i pamort, i paemër, i panjerëzi, i pafe, i pashtëpi, i pabesë, i pabesim, i pafuqi, i paligj, i pakor, të pashërbëtyrë, të pashërbëtorese*. Temat emërore pohore prej nga janë formuar këta mbiemra mund të jenë me parafjalën me: me gojë, me ujë, me plang etj.<sup>7</sup>

*Nyjëzim dhe prapashtesim njëkohësisht*: Në librin e Buzukut, numri më i madh i mbiemrave u formua me paranyjëzim dhe prapashtesim. Kjo mënyrë fjalëformimi, sikurse në shqipen sot, është mjaft prodhimtare edhe në veprën e Buzukut. Me këtë mënyrë janë formuar mbiemra nga temat emërore, foljore e ndajfoljore dhe të numërorëve themelorë. Prapashtesat që i gjejmë të përdorura janë: –shim, –(ë)t(ë), –(ë)r(ë), –(ë)m(ë), dhe –ë.

Në librin e parë shqip, me paranyjëzim dhe me prapashtesën –shim gjejmë disa mbiemra, të formuar nga tema fjalëformuese emërore dhe ndajfoljore. Tipologjia e shpjegimit të këtyre mbiemrave është “që është +folje” apo “që ka + folje”<sup>8</sup>.

- mbiemra të prejardhur me këtë prapashtesë nga tema fjalëformuese emërore na dalin: *i ndershim, i nevojshim, i engaeshim, i feshim, i mëshiershim, të sheshime*;

<sup>4</sup> Memisha, V. *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe*, Gjirokastër, 1999, f. 8.

<sup>5</sup> Arapi, I. *Tipat strukturorë të mbiemrave në veprën “Çeta e profetëve” të Pjetër Bogdanit*, S. F. 1990/1 f. 47.

<sup>6</sup> Gramatika e gjuhës shqipe, I, Tiranë, 2002, f. 196.

<sup>7</sup> Mulaku, R. *Parashtesat dhe prapashtesat e gjuhës shqipe në shkrime të vjetra*, Prishtinë 1998, f. 52.

<sup>8</sup> Memisha, V. *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe*, Gjirokastër, 1999, f. 28.

dhe nga tema foljore: *e dhimshime, i dhunuoshim, i duruoshim, i dishim, i rreshim, e ngënjyeshime, i vëjyeshim, të zdrifime,*

- me nyjëzim dhe me prapashtesën *-(ë)t(ë)*, nga temat emërore kemi: *i artë, i druajtë, të mëndashtë;* nga tema ndajfoljore: *të shumëtë;* nga tema të numërorëve themelorë: *të parëtë, i dytë, i katërtë, i pestë, i gjashtë, i nëntë, etj.*

- me nyjëzim dhe me prapashtesën *-ër(ë)*, te Buzuku e gjejmë fjalën *i poshtërë*, nga tema ndajfoljore *poshtë*. Kjo fjalë që në shikim të parë na duket si formë thjesht toske, nuk është e huaj për Gegërinë, edhe sot ndihet në Veri rregullisht në emërtime vendesh: Reka e epër, Reka e poshtër, etj.<sup>9</sup>

Kjo prapashtesë në shqipen e sotme nuk është prodhimtare.

- me nyjëzim dhe parashtesën *-m*, nga tema ndajfoljore gjejmë: *e mbrapëme, e sodme, i tepërm, i tukejm, i vetëm.*

- me nyjëzim dhe parashtesën *-ë*: *i enbërshelë, i enbjellë, i sjellë.*

*Nyjëzim, parashtesim dhe prapashtesim njëkohësisht:* Kjo mënyrë fjalëformimi, në veprën e Buzukut nuk është prodhimtare. Na dalin vetëm dy mbiemra (nga temat emërore): *i përmortshim* dhe *i përhirshim*.

Në shqipen e sotme kjo mënyrë fjalëformimi është mjaft prodhimtare.

*Mbiemra të formuar me kompozim:* Formimet me kompozim i hasim që në librin e parë shqip. Kompozitat mbiemërore të Buzukut, kanë lidhje nënrenditëse midis gjymtyrëve, pra janë kompozita përcaktore të tipit bahuvrihi (atributive a pronësore). Sipas gjymtyrëve që i përbëjnë, këto kompozita i ndajmë në:

- kompozita të përbëra nga tema emërore dhe mbiemërore: *diekeq* (e prej kësaj edhe *dijekeqi*), *hijekeq*, *gojëarti*, *zemërdëllirë*, *zemërkeq*, *zemërdërrjtëve*, *zemërdhimshimi*.

- kompozita të përbëra nga tema emërore dhe pjesorja e foljes: *zemërkëmbiem*.

- kompozita të përbëra nga tema emërore dhe temë ndajfoljore: *hirplota*.

- kompozita të përbëra nga një pjesore dhe një ndajfolje: *bakeq*, *kujtuokeq*, *bamirë*, *dashunmirë*.

Disa kompozita mbiemërore të Buzukut, janë kalke të mirëfillta nga latinishtja: *i vetëmëlenë* sipas lat. *unigenitus*, *i parilenë* lat. *Primogenitus*,<sup>10</sup> etj.

Në veprën e Buzukut, klasa e mbiemrave na dal mjaft e pasur me mënyra dhe mjete të ndryshme fjalëformuese. Në veprën “Meshari”, sikurse në shqipen e sotme, paranyjëzimi (duke përfshirë edhe mënyrat e përziera, paranyjëzim e prapashtesim njëkohësisht, paranyjëzim e parashteso-prapashtesim njëkohësisht), me mbi 150 formime, është mënyra më prodhimtare e formimit të mbiemrave. Pastaj vjen parashtesimi (me parashtesat më prodhimtare *pa-* dhe *për-*, me 13, përkatësisht 7 formime), kompozimi me mbi 15 formime, ndërsa prapashtesimi është më pak prodhimtar në formimin e mbiemrave të Buzuku (më prodhimtare është prapashtesa *-ar*, me të cilën kemi gjetur 3 mbiemra).

<sup>9</sup> Çabej, E. *Studime gjuhësore*, VI, Prishtinë, 1988, f. 75.

<sup>10</sup> Arapi, I. *Tipat strukturorë të mbiemrave në veprën “Çeta e profetëve” të Pjetër Bogdanit*, S.F. 1990/1 f. 53.